



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gllogocit/Drenasi
Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		17/12/	20.25
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400/01-		53163	

PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET I KOMUNËS SË DRENASIT I PËRDITËSUAR PËR VITIN 2026



KOMUNA GLLOGOC

Përmbajtje

Deklarata e Integritetit	3
Përkufizimi i termave	5
1. Hyrje.....	6
2. Plan i për Integritet.....	6
3. Parimet e menaxhimit të Integritetit	8
3.1 Lidershipi.....	8
3.2 Përfshirja e personelit.....	8
3.3 Qasja sistemore	8
4. Objektivat dhe qëllimet e Planit të Integritetit.....	8
4.1 Qëllimi i Planit të Integritetit.....	9
5. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit.....	9
5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit	10
5.2 Procesi i vlerësimit të rrezikut	10
5.2.1 Matrica vlerësimit të rrezikut	10
5.2.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut	11
6. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi	12
7. Fushat e rrezikut.....	13
7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut	13
7.2 Fushat specifike të rrezikut.....	13
8. Pyetësi.....	14
9. Tabela me fushat e përgjithshme dhe të veçanta të rrezikut	14

Deklarata e Integritetit

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklarate gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikatat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale, rregulluese.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio – ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që komuna të përmbushë objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimtë Kundër Korrupsionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i komunave në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit.

Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikon që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Zotohemi që Komuna e Glogocit/Drenasit, me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parimet dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo profesionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i riskut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e riskut ndaj integritetit në kulturën organizative të komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për

parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individë, si organizatë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojme sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, Ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës Glllogocit, dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

**Ramiz Lladrovci**
Kryetari i Komunës

Dhjetor, 2025

Përkufizimi i termave

Integritet: ndershmëri individuale, sjellje në përputhje me vlerat dhe parimet morale, integritetin institucional, përputhshmëri dhe qëndrueshmëri në veprime.

"Integriteti është parimi i të vepruarit vazhdimisht në përputhje me vlerat etike dhe profesionale".

Rreziku në kontekstin e Planit të Integritetit: mundësia e shfaqjes së dëmit për shkak të ngjarjes së tashme apo të ardhme, e cila rrezikon integritetin e një institucioni, d.m.th. ndikim në shfaqjen e korrupsionit, praktika etike dhe profesionale të papranueshme dhe parregullsi të tjera.

Ndikimi i rrezikut: vlera e dëmit për të mirën ose vlern publike të mbrojur (ndikimi i rrezikut mund të jetë i ulët, i mesëm ose i lartë).

Probabiliteti-mundësia e rrezikut: pasoja e dëmit të shkaktuar ndaj një të mire ose vlere publike të mbrojtur (rreziku mund të jetë i ulët, i mesëm ose i lartë).

Verësimi i rrezikut: vlerësimi i gjendjes aktuale të ekspozimit të një institucioni ndaj një rreziku specifik në një fushë të caktuar, të një intensiteti të ulët, mesatar ose të lartë, dhe rezulton nga vlerësimi i ndikimit të rrezikut dhe probabiliteti i rrezikut.

Masa aktuale e menahimit të rrezikut: masë eventuale e aplikuar nga një institucion, e cila shërben për të reduktuar rreziqet e korrupsionit në një fushë të caktuar.

Masa e përmirësimit: masë e cila pas vlerësimit të masave të menaxhimit aktual të rrezikut, mund të reduktojë rrezikun e korrupsionit në një fushë/proces të caktuar.

Aktiviteti: veprimet që duhen ndërmarrë për zbatimin e masës së përmirësimit.

Fusha: një fushë kyçe në funksionimin e një institucioni d.m.th., në përmbushjen e mandatit të tij, e cila për shkak të natyrës mund të jetë rrezik korrupsioni.

Procesi: një grup aktivitete të ndërlidhura të nevojshme për funksionimin brenda një fushe, p.sh. kompetenca, ndërsa procesi është një term më specifik se fusha d.m.th., çdo fushë përbëhet nga një grup procesesh të lidhura (rreziku).

Pyetësori: është instrument kërkimor i dizajnuar për mbledhjen e informacioneve të nevojshme për arritjen e qëllimeve kërkimore të synuara.

1. Hyrje

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Glllogocit/Drenasit, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së Komune dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës.

Plani rritet përkushtimin e komunës së Glllogocit/Drenasit për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

2. Plani për Integritet

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejt i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, Plani ofron masa të mbështetura tek riziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në Komunë;
- Vlerësimin e çfarëdo lloji rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë ; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo profesionale.

Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Komuna e Glllogocit/Drenasit të arrijë objektivat e saja organizative duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion;

- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet në dispozicion kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsion përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimi, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të punonjësve komunal dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Komuna.

Me zbatimin e këtij Plani, komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Gjithashtu, komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikrat dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të riskut që Komuna e Glllogocit/Drenasit e ka bërë në periudhën 2023 - 2026. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh: (1) dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin parë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikrat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

3. Parimet e menaxhimit të Integritetit

3.1 Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshëm të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjithë stafi dhe palët interesit.

3.2 Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

3.3 Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga Komuna që të kushtojnë vëmendje të gjitha të gjitha njësitë dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Një gjë e tillë arrihet brenda për brenda grupit punues në Komunë.

4. Objektivat dhe qëllimet e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe renditë përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës ku të gjithë individët dhe njësitë në komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

4.1 Qëllimi i Planit të Integritetit

Qëllim i Planit të Integritetit është:

- Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

5. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të komunës. Të gjithë të stafit komunal kanë mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit për Komunën e Glllogocit/Drenasit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza parë** - Kryetari i komunës ka themeluar grupin e punues me vendim, ndërsa në grup punues janë përfshirë disa anëtar. Po ashtu, Kryetari me vendim ka emëruar edhe koordinatorin për zhvillimin e planit të integritetit; Grupi punues bënë mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe ka shqyrtuar kornizën ligjore dhe dokumentacione tjera për të hartuar Planin e Integritetit.
- **Faza e dytë** - gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues kanë përpiluar pyetësinorin gjithëpërfshirës dhe mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale janë përcaktuar fushat e rrezikut dhe është bërë identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve.
- **Faza e tretë** – është bërë përcaktimi i prioriteteve dhe propozimi i masave për përmirësimin e integritetit - kjo fazë përfshin përcaktimin e prioriteteve për intervenimin, përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim.

5.2 Procesi i vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuar, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

5.2.1 Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitet të komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin duke përdorur matricën e rrezikut, “ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)”, të treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 deri në 100, si në tabelën e më poshtme:

 **Rreziku me intensitet të ulët** - mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 **Rreziku me intensitet të mesëm** - ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 **Rreziku me intensitet të lartë** - korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishme në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

6. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani i integritetit është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen. Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. **Grupi punues** - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:
 - promovimin e integritetit në komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike të;
 - hartimin e draftit të Planit të Integritetit dhe prezanton te grupi punues;
 - përgatitjen e programit për zhvillimin e planit të integritetit;
 - siguron që Planit të Integritetit në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
 - zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
 - propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
 - sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planin e Integritetit.

2. Koordinator për integritet - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Përgatitë metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të komunës, i cili është bazë për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- përgatitë dhe shpërndan pyetësoin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit dhe Kuvendit.

Koordinatori gjithashtu mbështet Grupin Punues në monitorim dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinator i thërret takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme nga ana e tij.

7. Fushat e rrezikut

7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Informimi dhe Mbrojtja e të Dhënave;

7.2 Fushat specifike të rrezikut

Fushat e specifike të rrezikut janë:

- Auditimi i Brendshëm;
- Menaxhimi i pronës komunale;
- Prokurimi publik;
- Rekrutimi, ofrimi i shërbimeve të Shëndetit publik;
- Rekrutimi i stafit dhe mirëmbajtja në Arsimin Publik;

8. Pyetësi

Ne kuadër të zhvillimit të Planit të Integritetit, Komuna e Drenasit ka krijuar pyetësin, ku kanë marr pjesë 42 pjesëmarrës, punonjës të administratës komunale, ku janë përfshirë kryesisht anëtarët e Grupit Punues dhe shefa të sektorëve dhe nga të dhënat që kanë dal nga ky pyetësor, del që Komuna e Drenasit qëndron mirë në aspektin organizativ dhe përgjegjësi të ndara në drejtori dhe sektorë. Të dhënat e marra nga pyetësi janë pasqyruar kryesisht edhe në Fushat e Përgjithshme të Rrezikut dhe Fushat e Veçanta të rrezikut. Në kuadër të Planit të Integritetit, ku janë paraqitur në formën tabelare fushat e rrezikut të ndarë në dy pjesë, në formën diagonale është bashkëngjitur edhe pyetësi me përqindje të rezultateve të fituara nga secila pyetje.

9. Tabela me fushat e përgjithshme dhe të veçanta të rrezikut

Në tabelën në vijim janë të paraqitura fushat e përgjithshme dhe të veçanta të rrezikut duke përfshirë përshkrimin e rrezikut, masat ekzistuese të kontrollit, vlerësimi dhe matja e rrezikut, masat e propozuara për zvogëlim/eliminim të rreziqeve, kostoja e zbatimit të masës, njësia/personi përgjegjës dhe afati i realizimit të veprimit ndaj rrezikut.

Masat e Veprimit të Planit të Integritetit
Të përditësuar për vitin 2026
Komuna e Drenasit

Fushat e përgjithshme të rrezikut	
-----------------------------------	--

Nr .	Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e Propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i Realizimit	Probabiliteti / Gjasa (1-10)	Pasojat / Ndikimi (1-10)	Vlerësimi i rrezikut
1	Drejtimi dhe menaxhimi	Sistematizimi jo adekuat i vendeve te punës.	Hartimi i rregullores së brendshme për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës. Ristrukturim I vendeve te punes	Sektorët e Burimeve Njerëzore Arsim, Personel dhe Shëndetësi	2026	7	7	49
2		Mungesa e hapësirës së Arkivit Komunal	Sigurimi i hapësirës adekuate dhe të mjaftueshme për Arkivin Komunal	Drejtoria e DKRS-së, DAP, DBF	TM2 2026	5	5	25
3	Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	Vështirësitë ne menaxhimin e kontratave të prokurimit	Përcaktimi i menaxherëve sipas lëmive përkatëse apo trajnimi i menaxherëve ekzistues	Njësia e Burimeve Njerëzore	2026	5	5	25
4		Menaxhimi jo efikas i ZGJC-së, në teren (Distanca, mungesa e kontrollimit të vijueshmërisë dhe deponimi i mjeteve financiare)	Rregullimi i sistemit të vijueshmërisë dhe kontrollit financiar	DAP/Spektori i Gjendjes Civile,	Qershor 2026	5	6	30
5		Mos mirëmbajtja e kamerave në ZGJC në Komoran,	Rregullimi dhe mirëmbajtja e kamerave dhe E-kioskave	DAP/Spektori i Gjendjes Civile	2026	4	6	24
6		Mos mirëmbajtja e E-kioskave në Drenas dhe Komoran	Rregullimi dhe mirëmbajtja e E-kioskave	DAP/Spektori i Gjendjes Civile	2026	5	5	25

7	Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Vonesa në përgatitjen e propozim-buxhetit Komunale	Informimi dhe dorëzimi me kohë i të gjitha propozimeve dhe materileve percjellese	Të gjitha drejtoritë dhe programet, Programeve dhe Nënprogrameve	2026	2	9	18
8		Mos Planifikimi në detale i planit të shpenzimeve	Takime vetëdijësuese me stafin në hartimin e planit të zotimeve dhe shpenzimit;	Programet dhe nën programet	TM1 2026	2	7	14
9		Vonesa në hartimin e planit të prokurimit	Hartimi me kohë i kërkesave nga programet dhe nën programet, angazhimi i stafit me kohë në hartimin e planit të prokurimit	Programet dhe nën programet	TM4 2026	3	6	18
10	Informim i dhe mbrojtja e të dhënave	Pamundësia e publikimeve me kohë të dokumenteve që lidhen me afatet kohore.	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht MAPL-në dhe ASHI-në.	Zyra e Kryetarit	2026	4	6	24
11		Mos zbatimi i rekomandimeve të gjetjeve të auditorit të jashtëm	1. Publikimi i raportit të auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare në webfaqen e komunës. 2. Formimi i komisionit për verifikimin e implementimit të rekomandimeve të AJ. 3. Raportimi në Kuvendin Komunal për implementimin e rekomandimeve të AJ.	Zyra e Kryetarit. Zyra për Informim. Komisioni për verifikim të implementimit të rekomandimeve	2026	2	8	16
12		Mungesa e trajnimeve të veçanta se si të punohet me të dhënat personale dhe të mbrohen të dhënat personale.	Të sigurohet që personeli marrin trajnim të veçantë për atë se si të punohet me të dhënat personale dhe të mbrohen të dhënat personale.	Zyra e Kryetarit	2026	5	5	25

Fushat e veçanta të rrezikut								
13	Auditimi i Brendshëm	Mungesa e Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Para se të hartohet Plani Strategjik dhe Plani Vjetor duhet që të kryhet një Rivlerësim i rregullt vjetor i rrezikut në mënyrë që këto plane të jenë tërësisht të bazuara në rrezik. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë kontrolleve	Njësia e Auditimit (hartimi i planeve). Kryetari i Komunës (miratim), dhe Komiteti i Auditimit (miratim).	TM4 2026	2	5	10
14		Pamjaftueshmëria e burimeve humane dhe financiare të komunës	Auditimi në personel dhe në buxhet.	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2026	2	5	10
15		Pamundësia e kryerjes së të gjitha auditimeve të parapara sipas Planit Vjetor të Punës.	Perfshirja në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, se paku edhe një auditor.	Kryetari i Komunës	2026	7	5	35
16		Mos implementimi i rekomandimeve nga ana e menaxhmentit	Njësia e Auditimit të Brendshëm në baza të rregullta gjashtëmujore dhe vjetore do të raportojë para Komitetit të Auditimit të Brendshëm në lidhje me gjendjen e rekomandimeve të dhëna.	Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Të gjitha drejtoritë.	TM2 DHE TM4 2026	3	6	18
17		Rënia e integritetit dhe qëndrueshmërisë së të dhënave të publikuara në Pasqyrat Financiare.	Auditime të shpeshta në lëminë e shpenzimeve të buxhetit	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2026	5	5	20

18	Menaxhimi i pronës komunale	Mungesa e monitorimit të duhur të pronave komunale të lëshuara në shfrytëzim	Monitorimin e pronave komunale të lëshuara në shfrytëzim	Zyrtari për Menaxhim të pronës Komunale. Zyra e Kryetarit	TM2 dhe TM4 2026	3	6	18
19	Prokurimi Publik	Mungesa e transparencës dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik	Identifikimi i nevojave për trajnime për zyrtaret që përfshihen në procedurat e prokurimit publik.	Njësia e prokurimit, NjBNj	2026	5	5	25
20		Mungesa e stafit të kualifikuar për menaxhimin e kontratave	Caktimi i stafit profesional, të certifikuar dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim të kontratave	Drejtorja e Administratës, NjBNj	2026	5	4	20
21	Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësior dhe Inspektori	Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve.	Të planifikohet rekrutimi i stafit të mjaftueshëm të inspektorëve.	Drejtorja e Inspektionit/Njësia e Burimeve Njerëzore.	2026	6	7	42
22	Rekrutimi, Ofrimi i Shërbimeve në Shëndetin Publik	Mungesa e Edukimit dhe Promovimit shëndetësorë në komunitet	Zbatimi i Planit lidhur me edukimin dhe promovimin shëndetësorë në komunitet,	DSHMS/ KPSH	2026	2	5	10
23	Rekrutimi dhe Menaxhimi i stafit në Arsimin Publik	Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve.	DKA nuk do të shpallë konkurse të reja, fillimisht, do të sistemohen mësimdhënës që mbesin pa normë si pasojë e rënies së numrit të nxënësve.	DKA dhe Shkollat	TM3 2026	7	5	35

Për zbatim dhe monitorim të zbatimit të planit duhet të përdoret MATRICA - Masat e Veprimit për Planin e Integritetit për 2026 e cila përmban edhe Veprimet e ndërmarra, Niveli i Zbatimit, Mjetet e verifikimit, Vështirësitë, Rekomandimet